Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 MASHTI në vitin 2021 (bazuar në planifikimin buxhetor) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 352,040€ në kategori ekonomike jo adekuate;

B2 Vlera e prezantuar në PFV për pasuritë kapitale ishte e mbivlerësuar për 1,101,848€, si rezultat i mos bartjes së tyre në regjistrat përkatës të shkollave - komunave. Po ashtu, edhe shtatë (7) njësi vartëse (programe) në kuader të MASHTI-it kanë paraqitur vlerën bruto të pasurive në PFV duke shkaktuar mbivlerësim të tyre. Ndërsa Universiteti i Prizrenit nuk ka paraqitur fare pasuri jo kapitale;

B3 Mbivlerësimi i pasurive në Qendrën e Studentëve në vlerë 174,751€; dhe

C1 MASHTI gjatë vitit 2021 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 142,698€ për 32 punonjës (të komunitetit serb të angazhuar me Marrëveshjen e Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmëri në punë dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek

pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Në dy (2) raste në vlerë 81,143€, OJQ-të janë subvencionuar pa i plotësuar të gjitha kriteret;

B4 Në 15 pagesa në vlerë totale prej 401,623€, urdhërblerja ishte bërë pas pranimit të faturës dhe pranimit të mallit apo shërbimit, përderisa në gjashtë (6) prej këtyre pagesave edhe zotimi ishte bërë pas pranimit të faturës; dhe

B5 Vonesat në pagesën e faturave në vlerë totale prej 1,051,478€ ishin prej 13 ditë deri një vit, përtej afatit të përcaktuar ligjor.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

1 Shpenzimet në vlerë 1,075,062€ nga kategoria e investimeve kapitale lidhur me një kontratë nuk janë auditur për shkak se janë në procedura hetimore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme

dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme;

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm;

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti; dhe

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2021 ka shpenzuar 88% të buxhetit final ose 63,934,474€ me një përmirësim prej 2% në krahasim me vitin 2020. Në kontekst të sistemeve financiare fushat ku janë identifikuar mangësi më të theksuara kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, pagesën e zyrtarëve të komunitetit serb në mungesë të evidencave për vajtje-ardhje në punë, vonesa në pagesën e faturave, mangësi në procedimin e pagesave, menaxhimin e proceseve të prokurimit, si dhe procesin e subvencionimit të OJQ-ve. Më tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet në regjistrat kontabël dhe si rezultat i gabimeve si dhe mos harmonizimit vjetor kemi mbivlerësim material të pasurive.

Kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive.

Ky raport ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, gjashtë (6) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

MASHTI në vitin 2021 (bazuar në planifikimin buxhetor) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 352,040€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Shpenzimet për furnizim me inventar në vlerë 108,614€ për shkollat ekzistuese nga kontrata "Furnizim me inventar në Shkollat e Arsimit Parauniversitar" ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale por që për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve;
- Shpenzimet në vlerë 231,181€ për "Furnizim me pajisje për salla të sportit në shkolla të arsimit parauniversitar" ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale por për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve;
- Nga kategoria e investimeve kapitale ishte kryer pagesa në vlerë 24,970€ për blerjen e pajisjeve të IT, pjesa prej 16,690€ i takon kategorisë së investimeve kapitale ndërsa pjesa tjetër prej 8,280€ i takon kategorisë së mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Pagesa në vlerë 3,965€ për blerjen e mobiljeve ishte paguar nga kategoria e investimeve kapitale por për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndarjes së mjeteve financiare me Ligj të Buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, pavarësisht kërkesës së MASHTI-it që mjetet për këto projekte të buxhetohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B1 Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mbivlerësimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja

Sipas nenit 13 pikës 1 dhe 2 të rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare, të gjitha transakcionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim.

Ne identifikuam si në vijim:

- MASHTI pasuritë e blera dhe investimet në ndërtim për shkollat e ulëta dhe të mesme të komunave të caktuara, në vlerë 1,101,848€, i kishte regjistruar në regjistrin kontabël të saj si pasuri. Këto pasuri ishin kryesisht inventar-pajisje të gatshme për shkolla si dhe objekti i një shkolle të pranuar teknikisht, por që nuk ishin bartur (transferuar) tek komunat-shkollat përkatëse. Pronësia dhe kontrolli i këtyre pasurive realisht ishte te shkollat (Komunat). Duhet theksuar se gjatë fazës së auditimit (maj 2022) MASHTI ka bërë kërkesë në Thesar për largim të pasurive nga regjistri i SIMFK-së; dhe
- Shtatë[4] (7) njësitë vartëse (programe) në kuadër të MASHTI kanë paraqitur vlerën bruto të pasurive jo kapitale në PFV duke shkaktuar mbivlerësim të tyre, përderisa Universiteti i Prizrenit nuk ka paraqitur fare pasuri jo kapitale në PFV.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i neglizhencës në zbatimin e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare nga zyrtarët përgjegjës si dhe problemet me funksionimin e sistemit e-Pasuria.

Ndikimi

Regjistrimi i këtyre pasurive si pasuri në përdorim dhe mos bartja e tyre në regjistrat e shkollave (komunave) përkatëse, si dhe mangësitë në prezantimin e pasurive nga njësitë vartëse kanë ndikuar që vlera e pasurive të mbivlerësohet/nënvlerësohet.

Rekomandimi B2 Ministrja duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, të barten në regjistrat e komunave të cilat i kanë nën administrim këto shkolla, si dhe bartja e pronësisë të bëhet me të gjitha procedurat formale. Po ashtu, në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive vartëse (programeve) të sigurojë se bëhet prezantimi i saktë i pasurive të tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësimi i pasurive në Qendrën e Studentëve

Gjetja Sipas rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19, pika 6, përcaktohet që të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas inventarizimit, duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël. Ne identifikuam se:

- Qendra e Studentëve nuk e kishte harmonizuar regjistrin e pasurive jo kapitale me ndryshimet e identifikuara sipas raportit të inventarizimit. Vlera e pasurive sipas evidencave të brendshme dhe komisionit të inventarizimit të pasurive ishte 1,604,798€, ndërsa vlera sipas sistemit e-pasuria ishte 1,775,074€ (sistemi e-pasuria nuk e kishte kalkuluar zhvlerësimin). Si rezultat i këtij gabimi pasuritë jokapitale të prezantuara në PFV, ishin të mbivlerësuara për 170,276€; dhe
- Pasuritë në vlerë 8,000€[5] ishin regjistruar gabim si investim në vijim me ç'rast pasuritë kapitale janë mbivlerësuar për 4,475€ si pasojë e mos zhvlerësimit të tyre.

Problemet me sistemin e-pasuria dhe neglizhenca gjatë raportimit të pasurive nga personeli përgjegjës i njësive vartëse (programeve) ishin shkaktarët e këtyre mangësive.

Ndikimi Mosbarazimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrin e e-pasurisë ka ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e pasurive jokapitale dhe prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B3 Ministrja në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprimet e duhura për prezantimin e plotë dhe të saktë të pasurive në PFV. Po ashtu, ndryshimet e konstatuara nga inventarizimi duhet të reflektojnë në gjendjen reale të pasurive jokapitale, duke u kujdesur që aplikimi i zhvlerësimit të pasurive është duke ndodhur në mënyrën e duhur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mungesa e evidencës për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojta Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve, përcakton se "Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Në kuadër të kësaj marrëveshje për integrim, në MASHTI përmes akt-emërimeve janë punësuar 32 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur ''Mbrojtja civile'' të cilët marrin paga të rregullta mujore. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët e Ministrisë këta të punësuar nuk kanë hapësira të përcaktuara të punës dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2021 ishte 142,698€.

Duhet theksuar se në shkurt/mars të vitit 2022, MASHTI si rezultat i mungesës së vijueshmërisë kishte marrë vendim që zyrtarët e lartë cekur të mos i paguaj. Pas reagimit të zyrtarëve, në prill 2022 me një vendim tjetër, MASHTI vendos që ti kthehej përsëri në listën e pagave dhe të bëjë pagesën në mënyrë retroaktive edhe për dy muajt paraparak, me arsyetimin se kishin arritur që të siguronin kontaktet e tyre dhe dakordimin për paraqitje në punë. Deri në fund të auditimit nuk kishte ndonjë dëshmi për vijueshmërinë e tyre në vendin e punës.

Kjo dukuri vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerr masa konkrete në krijimin e hapsirave fizike për punë, sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi

Pagesa e pagave për punonjës që nuk paraqiten në punë, shkakton dëmtim të buxhetit të ministrisë si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara me marrëveshje, pra integrimin e këtij komuniteti në sistemin e Republikës së Kosovës.

Rekomandimi C1

Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në procesin e subvencionimit të OJQ-së

Gjetja

Në thirrjen publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që mbështesin nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë, si dhe nxënës të tjerë, që kontribojnë në arritjen arsimore, kërkohej dëshmi para nënshkrimi të kontratës që personi përgjegjës në OJQ nuk është nën hetime për vepër penale, dhe dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) se OJQ-ja nuk ka borxhe tatimore dhe detyrime të tjera të papaguara.

Në dy (2) mostra të testuara në vlerë 41,463€ respektivisht 39,680€, vërejtëm se OJQ-të përfituese nuk kishin ofruar dëshmi para nënshkrimit të kontratës, se personi përgjegjës në OJQ nuk është nën hetime për vepër penale (dëshmitë janë ofruar gjatë auditimit në muajin maj 2022). Kurse njëra OJQ nuk kishte ofruar dëshmi vërtetimin për të dëshmuar se nuk ka borxhe ndaj ATK-së, por kishte ofruar një deklaratë që ka probleme teknike në sigurim të vërtetimit në ATK.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i pa përgjegjësisë nga ana e personave të obliguar për tu siguruar se gjithë procesi ishte zhvilluar në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e thirrjes publike.

Ndikimi

Mos përfillja e plotë e kërkesave të kërkuara me thirrjen publike mund të rezultojë në përzgjedhje jo të drejt e të bazuar në kërkesa ligjore, shkelje të parimit për trajtim të barabartë të aplikuesve duke rrezikuar që mjetet të mos shpenzohen për qëllimin e dhënë.

Rekomandimi A1

Ministrja duhet të siguroj që kriteret e vendosur në thirrjen publike të aplikohen në tërësi dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja

Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura.

Ne identifikuam se:

- Në gjashtë (6) raste (vlera e pagesave 207,635€) zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës; dhe
- Në 15 raste (vlera e pagesave 401,623€), urdhërblerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës.

Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B4

Ministrja duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Në tetë[6] (8) raste në vlerë 1,051,478€ kemi vërejtur se faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor. Pjesa më e madhe e vonesave lidhen me kontratën "Blerja e licencave të pakos softuerike Gjuha Shqipe dhe Kompjuteri". Vonesat në pagesën e faturave sillen prej 13 ditë deri në një vit, përtej afatit të përcaktuar ligjor.

Vonesat në pagesën e obligimeve kishin ndodhur për shkak të mungesës së buxhetit dhe kontrolleve jo të mira në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi

Vonesat në pagesën e faturave mund të krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues, ku përveç pagesave të faturave Ministria mund të jetë edhe pjesë e padive nga OE si rezultat i vonesave të mëdha në kryerje të obligimeve të saj.

Rekomandimi B5

Ministrja duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuara të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 20,709,702€, prej tyre ishin shpenzuar 15,416,203€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për ndërtimin e objekteve arsimore, pajisjeve të teknologjisë informative, softuer, blerja e inventarit dhe pajisjeve laboratorike si dhe blerja e pajisjeve për salla sportive.

Çështja A2 - Vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve

Gjetja

Sipas nenit 41.2 të Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda përiudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo përiudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve".

Në procedurën e prokurimit "Renovimi i SHFMU në fshatin Prapaqan-Deçan dhe rregullimi i oborrit dhe fushës sportive per femijë në SHFMU "Hysni Temaj" në fshatin Kushnin-Prizren" vlerësimi i tenderëve kishte filluar 43 ditë pas hapjes së ofertave, ndërsa ka përfunduar 166 ditë pas hapjes së ofertave.

Vonesa në fillimin e vlerësimit ka ndodhur si pasojë e mos krijimit të komisionit, ndërsa vonesa në vlerësim ka ndodhur si pasojë e numrit të madh të ofertave.

Ndikimi

Vonesa në vlerësim të tenderit përveç anashkalimit të rregullave ka ndikuar edhe në vonesë në lidhje të kontratës e rrjedhimisht në shtyrjen e realizimit të punimeve dhe marrjen e shërbimeve për qytetar.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të siguroj se vlerësimi i ofertave fillon dhe përfundon brenda afateve të përcaktuara, duke mundësuar që punët të fillojnë në kohën e duhur. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shqyrtohen zgjidhjet e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë mbi afatin e përcaktuar

Gjetja

Sipas nenit 56.18 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, "Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo ripërtërihet që nënkupton se kohëzgjatja e kontratës duhet të përcaktohet në fillim të procesit të prokurimit. Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit.

Gjatë testimit të procedurave të prokurimit në Qendrën e Studentëve kemi vërejtur se në dy (2) kontrata publike kornizë ka zgjatje të kontratës si në vijim:

- Kontrata "Renovimi i nyjeve sanitare" ishte nënshkruar me datë 02.08.2021 me kohëzgjatje deri më 02.10.2021 dhe e njëjta ishte zgjatur deri me datë 30.11.2021; dhe
- Kontrata "Furnizim me pajisje industriale për kuzhinë" ishte nënshkruar me datë 23.02.2021 me kohëzgjatje deri më 23.05.2021 dhe e njëjta ishte zgjatur deri me datë 20.06.2021.

Bazuar në analizën e gjendjes së procesit të prokurimit vërehet se zyra e prokurimit nuk ka bërë ndonjë analizë se cila nga procedurat e prokurimit është adekuate për realizimin e këtyre kontratave, dhe nuk i ka analizuar kufizimet që i ka lidhja e një kontrate kornizë në aspektin kohor.

Ndikimi

Aplikimi i procedurës jo adekuate dhe kohëzgjatja e kontratës publike kornizë mbi afatin e përcaktuar përveç që është në kundërshtim me rregulloren e prokurimit ndikon edhe në pamundësinë e zgjatjes së afatit kur ka arsye të plotë nga përgjegjësit e menaxhimit të kontratave.

Rekomandimi A3

Ministrja në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që menaxheri i prokurimit kryen analiza të sakta në lidhje me natyrën e prokurimeve që do të zhvillohen dhe përzgjedh procedurat adekuate të prokurimit që mundësojnë realizimin e kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Pranimi dhe pagesa e punëve/ furnizimeve të parealizuara

Gjetja

Sipas nenit 8.4 të Rregullores për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, "Komisioni për Pranimin e Pasurisë jo Financiare ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhmëri me kontratën apo urdhërblerjen. Gjithashtu sipas Sipas nenit 61.19 të RrUOPP, menaxheri i projektit do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë.

Sipas kontratës trevjeçare "Furnizimi me pajisje për salla të sportit në shkolla të arsimit para universitar" MASHTI do të furnizoj 40 shkolla me pajisje të sportit me nga 61,913€. Nga ekzaminimi fizik i tri (3) shkollave [7] gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur se pozicionet në vlerë totale 9,243€ nuk janë kryer/montuar (në raste të caktuara në mungesë të parakushteve për kryerjen e disa pozicioneve) edhe pse janë paguar.

Pas konstatimit të kësaj gjendje nga auditimi, menaxheri i kontratës ka ndërmarrë veprime të menjëhershme dhe një pjesë e pozicioneve janë përmbushur (vlera 1,751€) kurse për pozicionet në vlerë 7,492€ që nuk ka pasur parakushte për realizimin e tyre mjetet janë kthyer në llogari të Ministrisë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve nga komisionet e pranimit në shkolla dhe nga mungesa e monitorimit nga menaxheri i kontratës.

Ndikimi

Monitorimi i pamjaftueshëm gjatë pranimit të punëve/furnizimeve nga Ministria dhe nga komisionet përkatëse të shkollave mund të ndikoj në mos përmbushjen e objektivave të parapara me këtë kontratë.

Rekomandimi A4

Ministrja duhet të siguroj se pagesat realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/furnizimeve të kontraktuara. Po ashtu, për shkollat tjera ku janë kryer punë/furnizime sipas kësaj kontrate duhet të realizohen vizita nga Ministria (menaxheri i kontratës) për të siguruar se janë kryer të gjitha furnizimet sipas kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 127,080,262€, pasurive jokapitale është 3,615,327€, si dhe e stoqeve 518,273€.

Çështja B6 - Mos kryerja me kohë e procesit të inventarizimit

Gjetja

Sipas rregullores nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19, përcaktohet që raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni I inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Administrata e MASHTI, nuk kishte arritur të kryej procesin e inventarizimit para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, (inventarizimi i pasurisë është kryer me datë 09.03.2022) dhe rrjedhimisht nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive jo financiare.

Vonesa në kryerjen e inventarizimit ishte si rezultat i mos funksionimit të duhur të kontrolleve në fushën e menaxhimit të pasurive.

Ndikimi

Vonesa në inventarizim dhe mos harmonizimi i regjistrit të pasurive me inventarizim ndikon direkt në mos azhurnimin e regjistrave me informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

Rekomandimi B6

Ministrja duhet të siguroj se procesi i inventarizimit të përfundoj me kohë, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, dhe të bëhet krahasimi mes gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[8]	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**64,116,454**	**72,767,773**	**63,934,474**	**54,198,552**	**62,770,301**
Grante Qeveritare – Buxheti	55,762,589	68,350,607	61,699,055	44,919,060	54,136,376
Financimi përmes huamarrjes	521,300	118,902	112,958	1,071,703	947,534
Të bartura nga viti i kaluar	0	451,033	413,289	1,104,293	873,166
Të hyrat vetanake	2,832,565	2,230,643	890,698	937,430	1,130,159
Te hyrat nga AKP-ja	5,000,000	0	0	5,540,373	5,329,825
Donacionet vendore	0	106,912	105,389	25,568	23,824
Donacionet e jashtme	0	1,509,676	713,085	600,125	329,417

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 8,651,319€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së buxhetit nga Granti Qeveritar si dhe nga donacionet.

Ministria në vitin 2021 ka shpenzuar 88% të buxhetit final ose 63,934,474€ me një përmirësim prej 2% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**64,116,454**	**72,767,773**	**63,934,474**	**54,198,552**	**62,770,301**
Pagat dhe mëditjet	19,655,821	20,384,912	20,345,560	19,162,565	18,641,975
Mallrat dhe shërbimet	14,772,973	25,109,304	22,554,296	14,490,316	20,994,126
Komunalitë	1,590,459	1,232,981	1,032,583	759,140	1,005,814
Subvencionet dhe transferet	6,041,929	5,330,875	4,585,831	3,977,731	2,564,237
Investimet Kapitale	22,055,272	20,709,702	15,416,203	15,808,800	19,564,150

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

• Buxheti final për paga dhe mëditje krahasur me buxhetin fillestar ishte rritur për 729,091€. Rritja ka ndodhur me rishikim të buxhetit prej 253,413€, donacioneve 18,354€, të hyrave vetanake për 55,441€ si dhe me vendime të qeverisë për 401,883€. Ndryshimet buxhetore kryesisht kanë të bëjnë me pagesat e pagave përmes vendimeve gjyqësore për mësimdhënës sipas kontratës kolektive. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte pothuajse 100%;

• Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 10,336,331€. Rritja ka ndodhur me rishikim të buxhetit prej 1,253,781€, donacioneve 1,341,678€, të hyrave vetanake 355,892€ si dhe me vendime të qeverisë kishte rritje për 7,384,980€ për pagesën e obligimeve për blerjen e librave. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 90%;


• Buxheti final për komunalitë krahasur me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 357,478€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit kishte zvogëlim për 92,614€, përmes të hyrave vetanake kishte rritje prej 25,219€ si dhe me vendime të qeverisë zvogëlim për 290,083€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 84%;

• Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 711,054€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit kishte zvogëlim për 1,330,578€, përmes të hyrave vetanake kishte rritje prej 14,480€, përmes donacioneve kishte rritje prej 30,960€ ndërsa me vendime të qeverisë kishte rritje të buxhetit për 574,084€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 86%; dhe

• Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,345,570€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit ku kishte zvogëlim për 379,500€, përmes donacioneve kishte rritje për 225,595€ ndërsa me vendime të qeverisë kishte zvogëlim të buxhetit për 1,191,665€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 74%. Ngecjet në realizim të disa projekteve për shkak të pandemisë COVID-19, si dhe mos pagesa e disa faturave me kohë ka ndikuar në mos realizim të buxhetit për investime kapitale.

MASHTI në vitin 2021 ka paguar 9,805,384€ për shpenzimet që lidhen me menaxhimin e pandemisë COVID-19 nga Mjetet e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Pako Emergjente Fiskale. Nga kjo vlerë 70,245€ janë shpenzuar në kategorinë e pagave, 8,495,139€ në mallra dhe shërbime si dhe 1,240,000€ në subvencione.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga MASHTI në 2021 ishin në vlerë 2,434,375€. Ato kanë të bëjnë me participimin e studentëve, akreditimin e programeve akademike, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	**2,363,981**	**2,664,070**	**2,434,375**	**1,839,613**	**2,935,179**
Të hyrat jo tatimore	2,363,981	2,664,070	2,414,044	1,748,692	2,882,838
Të hyrat tjera	0	0	20,331	90,921	52,340

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të MASHTI ka rezultuar në 22 rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, kemi një progres të mirë në zbatimin e rekomandimeve, pasi 15 rekomandime janë zbatuar, një ishte në proces dhe gjashtë (6) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.	Pavarësisht kërkesave nga MASHTI për ndarjen e buxhetit në kategorinë adekuate vërehet se kjo nuk kishte ndodhur nga Kuvendi i Kosovës. Edhe gjatë vitit 2021 kemi hasur në raste të keqklasifikimit. Shih B1.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Ministri, duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, të barten në regjistrat e komunave të cilat i kanë nën administrim këto shkolla, si dhe bartja e pronësisë të bëhet me të gjitha procedurat formale.	Edhe gjatë vitit 2021 kemi hasur në pasuri të cilat nuk janë bartur tek komunat. Shih B2	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për heqjen e pasurive të dyfishuara si dhe aplikimin e zhvlerësimit të pasurive në e-pasuri në mënyrë që ky regjistër te reflektoj gjendjen reale te pasurive jokapitale.	Edhe gjatë vitit 2021 kemi hasur në raste të tilla. Shih B3.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të dhënat kontabël të jenë të harmonizuara me gjendjen faktike të borxheve, dhe me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare të shpalos të gjitha transaksionet që kanë rezultuar me pranim të mallrave apo shërbimeve, dhe për të cilat pritet dalje e sigurt e parasë.	Obligimet për blerjen e librave janë paguar në përfundim të vitit 2021.	I zbatuar
5.	Baza për opinion	Ministri, në bashkëpunim me Zyrtarin Kryesor Financiar duhet të siguroj që të qartësohen me Thesarin të gjitha çështjet në lidhje me pagesat, për tu siguruar që njohja e shpenzimeve dhe paraqitja e tyre në pasqyrat financiare të bëhet vetëm pas konfirmimit të daljeve të mjeteve nga llogaria bankare.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë vitit 2021.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuara të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh.	Edhe gjatë vitit 2021 kemi hasur në vonesa në pagesen e faturave më shumë se 30 ditë. Shih B5.	Nuk ka filluar zbatimi

7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj se nuk do të paguhen kompensimet për stafin e brendshëm të angazhuar në grupe punuese dhe komisione, përderisa angazhimet kryhen brenda orarit të rregullt të punës.	Pas publikimit të Raportit të Auditimit për vitin 2020, ne nuk kemi hasur në pagesa për kompensime të anëtarëve të angazhuar në komisione apo grupe punuese për punët që kryhen brena orarit të rregullt të punës.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Ministri, duhet të siguroj një mbikëqyrje më strikte ndaj realizimit të projekteve, duke kërkuar që për çdo kontratë të raportohet rregullisht ecuria e realizimit të projektit në përputhje me planin detal dhe në rast të zgjatjes së periudhës së realizimit, kjo të bëhet vetëm me aprovimet përkatëse me shkrim ku definohen afatet e qarta të përfundimit të projekteve.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
9.	Baza për konkluzion	Ministri, në bashkëpunim me Rektorët e Universitetit të Pejës dhe Universitetit të Gjilanit, duhet t'i shqyrtojnë rastet e mësipërme dhe të parandalojnë rastet tjera që paramasat dhe pozicionet e punimeve të ndryshohen pa aprovimet e kërkuara sipas rregullave dhe procedurave të prokurimit.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
10.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj që kontratat duhet të nënshkruhet vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë së tenderëve.	Gjatë këtij viti nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
11.	Baza për konkluzion	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që para nënshkrimit të kontratave, të sigurohet se ka fonde të mjaftueshme në pajtim me ndarjet buxhetore, dhe se informatat financiare në DNPDF, duhet të ri-konfirmohen para publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
12.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Rektorin e Universitetit të Pejës dhe Drejtorin e Qendrës së Studentëve duhet të sigurojnë se vlerësimi i tenderëve bëhet në pajtim të plotë me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
13.	Baza për konkluzion	Ministri, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit të përfundoj me kohë, para përgatitjes së pasqyrave financiare	Edhe gjatë vitit 2021 kemi hasur në raste të njëjta. Shih B6.	Nuk ka filluar zbatimi

		vjetore, dhe të bëhet krahasimi mes gjendjes se inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë, si dhe të gjitha pasuritë jokapitale të regjistrohen dhe raportohen përmes sistemit e-pasuria, në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV.		
14.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguroj se asnjë kontratë e cila ka për qëllim realizimin e saj brenda vitit fiskal, nuk do të nënshkruhet pa siguruar zotimin e mjaftueshëm të fondeve për realizimin e saj.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
15.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar vijueshmërinë e rregullt të këtyre punonjësve në vendin e punës, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Edhe për vitin 2021 ministria nuk kishte arritë që të sigurojë vijushmerinë e rregullt të këtyre punonjësve në vendin e punës. Në shkurt dhe mars të vitit 2022 ministria kishte marrë vendim që zyrtarët e lartë shënuar të kalojnë me zero në listën e pagave. Ndërsa në prill me një vendim tjetër, ministria vendos që të kthehen përsëri në listën e pagave. Si rezultat kishte arritur që të siguronte kontaktet e tyre dhe dakordimin e tyre për paraqitje në punë. Shih C1	Pjesërisht i zbatuar
16.	Pagat dhe mëditjet	Ministri përmes mekanizmave përkatës ligjor në dispozicion duhet të inicioj rishikimin e rregulloreve të universiteteve për kompensimin e komisioneve të brendshme në mënyrë që ato të jetë në harmoni me normat e përgjithshme ligjore të menaxhimit të financave publike.	Nga mostrat e testuara kemi identifikuar se ministrja në bashkëpunim me Universitet kishin adresuar rekomandimin e dhënë në raport të auditimit.	I zbatuar
17.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve dhe Rektorët e Universiteteve, duhet të forcojnë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojnë zbatimin e procedurave, duke filluar nga inicimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Edhe gjatë vitit 2021 kemi hasur në raste të njëjta. Shih B4.	Nuk ka filluar zbatimi

18.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri, në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë ekonomike dhe transparente, duke zbatuar normat ligjore dhe eliminuar mundësinë që produktet e njëjta të furnizohen me kontrata të ndryshme dhe me çmime më të larta.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
19.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkalimet e furnizimeve. Në rastet kur tejkalimi i porosive për artikuj arrin shkallën 30% mbi sasitë indikative, kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
20.	Investimet kapitale	Ministri, duhet të siguroj se zyra e prokurimit, shqyrton me përpikëri përmbushjen e kërkesave nga operatorët ekonomik, me rastin e nënshkrimit të kontratave, duke u siguruar që siguria e ekzekutimit e mbulon tërë kohëzgjatjen e kontratës.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
21.	Çështjet e përbashkëta	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të siguron ndarjen e drejtë të detyrave ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Zyrtarët nga njësia kërkuese të cilët janë të përfshirë në hartimin e specifikave nuk duhet të caktohen në vlerësimin e tenderëve.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar
22.	Detyrimet Kontigjente	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime konkrete, për t'i eliminuar dobësitë në menaxhimin e informatave për detyrimet kontigjente, duke inicuar një azhurnim të regjistrit aktual, si dhe të nxisë një bashkëpunim më të afërt dhe efikas mes zyrës se financave dhe asaj ligjore, në mënyrë që informatat e shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të plota.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla për vitin 2021.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 7
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: 1
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 1322
Data: / Datum: / Date: 13.05.2022
Prishtinë / e

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke,tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**, për vitin 2021.
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Arbërie Nagavci,

Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Data: 13 qershor 2022

Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[9] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[10], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Agjencioni per Arsim dhe Aftësim Profesional, Agjencioni Kosovar i Akreditimit, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Administrata Qendrore, Instituti i Historisë, Instituti Pedagogjik, Universiteti i Gjilanit

[5] Makinë industriale për tharjen e rrobave me avull dhe elektonike e blerë në vitin 2021 në vlerë 4,500€ dhe Automjet në vlerë 3,500€ i regjistruar në vitin 2006

[6] Faturat për kontraten "Blerja e licencave të pakos softuerike Gjuha Shqipe dhe Kompjuteri" në vlerë 809,200€ ishin paguar me 231, 236, 238 dhe 266 ditë vonesë; Fatura për "Ndërtimi i fakultetit të arteve (Faza e katërt) në vlerë 70,428.28€ në Universitetin e Pejës, ishte paguar me 334 ditë vonesë; Fatura për Shërbime të xhirimit të njësive mësimore" në vlerë 83,132€ ishte vonesë në pagesë 38 ditë si dhe fatura për Ndërtimi I shkollës fillore në Vraniq Suharekë" fatura në vlerë 88,717.21€ ishte vonesë 13 ditë.

[7] SHFMU "Afrimi e Fahriu" Lluzhan, pozicionet 1 dhe 77 sipas kontratës në vlerë 3,259€; SHFMU "Emin Duraku" Bajqinë pozicioni 75 sipas kontratës në vlerë 1,360€; dhe SHFMU "Ali Kelmendi" Barilevë pozicionet 2, 75,76 dhe 77 sipas kontratës në vlerë 4,624€.

[8] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[9] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[10] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.